




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

**URDHËR**  
**“PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”**

**Drejtuar: Qëndres Kombëtare Të Regjistrimit**  
**Debitorit: Z. Fatjo Bujar Latifi, TV Krutja.**



Unë, Përmbarues Gjyqësor Andi Kocaqi, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlorë Nr. 73 datë. 17.02.2015, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 36, Datë 25.03.2016 kërkesën e kreditorit Zyra Shqiptare Për Të Drejtat E Autorit ndaj debitorit person fizik Fatjo Latifi, në lidhje me titullin ekzekutiv Kundravajtjen Administrative (flete-gjobe) Nr.00302 datë. 14.10.2014.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 155 Prot, Datë 25.03.2016, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr. 73 datë. 17.02.2015 në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

**URDHËROJ**

- 1. Heqjen e sekuestros ne Q.K.R mbi aktivet e debitorit person fizik Fatjo Latifi me nipt K94223402E me seli ne Korçë.**
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet te na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë ne zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në neni 606 e në vijim te K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve nga marja dieni.

**B.S.E BAILIFF SERVICE EXECUTIVE SH.P.K**

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**ANDI KOCAQI**

